



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVESHKOLLA E MESME
PROFESIONALE "THOMAPAPAPANO", GJIROKASTËR

Nr. 152 prot.

Gjirokastër, më: 06.09.2024

Lënda : Njoftim për lëvizje paralele

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr. 15/2017, "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe Aspektet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore , Përbërjes së Njësisë së Zhvillimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional", të Udhëzimit nr. 25, datë 01/09/2023 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në Ofruesit e Arsimit Profesional",

Shkolla e mesme profesionale "Thoma Papapano" Gjirokastër ,ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin :

1.Mësues i Teorisë Profesionale , drejtimi Shërbime Mjete Transporti, me kohë të plotë.

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit

f) të demonstrojë aftësitë punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

a) Të ketë diplomë të nivelit master shkencor ose të barasvlefshme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së.

b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit.

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) Letërmotivimin për pozicionin;

b) Jetëshkrimin (Cv-në sipas shtojcës 11 të udhëzimit 14 dt. 27.05.2021).

c) Kartën e identitetit;

d) Diplomën;

e) Librezën e punës;

f) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet ,trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

g) Certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h) Vërtetimin e gjëndjes shëndetësore;

i) Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore;

j) Vërtetimin nga punëdhënësi I fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi

k) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

l) Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

m) Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

1. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, 23.09.2024

DREJTOR

Renata Puleni

